

KOMBËTARE

BIBLIOTEKA

60  
427

TIRANE

427

# STATUTI

i

## KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPRIË



KORÇË  
1929

147

Gjithë kleri dhe populli Orthodhoks i Mbretërisë Shqiptare, i përfaqësuar prej Delegatëve fuqiplotë të mbledhur në Kongresin e Dytë që u-mbajt në Korçë, voton me një za statutin definitiv të Kishës Orthodhokse Shqiptare, të proklamuar Autoqefale në Kongresin e Beratit me datë 12 Shtator, 1922.

#### KAPTINA E I

### Kisha

Art. 1. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së Shënjtës Kishë të Përgjithëshme dhe Apostolike, përbahet prej tërë banorëve të Mbretërisë Shqipëtare që i besojnë Krishtit dhe pohojnë Simbollin e Shenjtë të Fesë

Orthodhokse (to simvolon tis pisteos) dhe ruan të patundëshme gjith sa pranon Kisha e Shenjtë Lindore e Krishtit, Themelonjës e Krye i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Iisu Krishti.

Art. 2. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë asht e bashkuar dogmatisht dhe shpirtërisht me të gjitha Patriarhitë e Shenjta dhe me Kishat Orthodhokse Autoqefale dhe ruan, pa nonjë ndryshim, si të gjitha Kishat e tjera Orthodokse të Krishtit, burimet e besimit, shkrimet e shënjta dhe gojëdhënat e Hirëshme (Agian Grafin qe Hieran Paradhosin) si dhe kanonet e Shenjta Apostolike dhe Sinodhike.

Art. 3. Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja.

Art. 4. Autoriteti më i lartë i Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare ashtë Sinodhi i Shënjtë Peshkopal i përbërë prej Peshkopëve aktivë të çdo Dhioqeze, prej Ikonomit të Math Mitrofor dhe i kryesuar prej Mitropolitit të Qendrës, Kryepishkopit të gjithë Shqipërisë.

Titulli Zyrtar i Sinodhit ashtë: "Sinodhi i Shenjtë i kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë".

Peshkopata e Qendrës merr titullin "Mitropoli" dhe titullari i saj quhet Mitropolit i asaj Dhio

qeze dhe Kryepeshkop i gjith Shqipërisë, Peshkopët e tjerë mbajnë titullin Peshkop dhe Dhioqezat e tyre Peshkopata.

Art. 5. Kisha Orthodhokse Shqiptare është person juridik dhe trashigon të gjithë titujt dhe të drejtat e komuniteteve Orthodhokse të gjer tanishëm.

#### KAPTINA E II

### Sinodhi i Shenjtë dhe detyrat e tija

Art. 6. Sinodhi i Shenjtë: Regullon Kishën Autoqefale të Shqipërisë për sa i përket besimit, adhurimit (Latria) disiplinës Kishëtare, organizimit dhe administrimit të brendëshëm të Kishës në bazë të dogmave dhe të kanuneve të Shenjta dhe në konformitet me Ligjet e Shtetit;

Ushtron kontrollimin mbi veprimet e Peshkopëve dhe të organeve të Kishës, sipas rregullave Kishëtare; themelon dhe mban Shkolla Fetare;

Harton programet e tyre dhe i mbikëqyr me anën e Peshkopëve:

Përkujdeset për edukatën fetaro-Kombëtare për kulturën dhe për të kryemit e detyrave

të Klerikëve e të Murgëve;

Kujdeset për edukatën fetare të popullit Orthodhoks me anën e predikimeve Kishëtare, të mësimëve Fetare edhe të redaktimit e të botimit të librave dhe të rivistave Fetare.

Art. 7. As një libër nuk munt të përdoret në Kishë pa pëlqimin zyrtarë të Sinodhit këshutë dhe në shkollë, për mësimet e Fesë Orthodhokse pa pëlqimin zyrtarë të Sinodhit dhe të Ministrisë s'Arësimit.

Art. 8. Librat e Kishës që janë përkthyer do të këqyren prej Sinodhit, i cili e ka për detyrë të kujdeset sa më shpejt për përkthimin dhe botimin e atyne librave të Kishës që mungojnë.

Art. 9. Sinodhi i Shenjtë detyrohet të vejë re që çdo vepër e paraqitur me anë botimesh, gravurash, çfaqesh teatrale, ose kinematografike dhe konferencash publike të mos çënojë ose çnderojë dogmat dhe dispozitat e Orthodoksisë ose për gjithsisht Klerin si dhe format e tija dhe, n'e pafte t'arësishme të kërkojë ndërhyrjen e autoriteteve, në konformitet me ligjet e Shtetit.

Kryesia e Sinodhit me pëlqimin e anëtarëve

vendos t'u japë diploma merite atyre që i kanë shërbye çashtjes Kishtare.

## Mbledhja e Sinodhit të Shenjtë

Art. 10 Sinodhi mbledhet rregullisht dhe me doemos një her në vit. Koha e mbledhjes asht ipso fakto data 1 Tetor. Mbledhja do të mbajë jo ma pak se 15 ditë dhe jo ma tepër se një muaj. Kryepishkopi, për nevoja të domos-doshme dhe me pëlqimin e shumicës së anëtarëve provokon dhe mbledhje të jashtëzakonshme të Sinodhit. Kryetari çel dhe mbyll mbledhjet.

Art. 11. Sinodhi ka kuorum kurë ndodhen prezentë gjysma plus një i numurit të të gjithë anëtarëve. Po kur do herë mbledhje legale munt të bahet vetëm kur, përveç Kryepeshkopit ndodhen dhe dy anëtarë të tjerë.

Në mungesë të Kryepishkopit, në rast që ky asht pushuar, Sinodhi Kryesohet prej ma të vjetrit në dorëzim; në rastë të tjera Sinodhi kryesohet prej Peshkopit t' autorizuar nga Kryetari me kompetencë të caktuar.

Art. 12. Vendimet e Sinodhit merren me shumicë votash.

Në rast njësie provokohet një mbledhje e dytë, në të cilën, në qoftë se ka përsëri njësi votash parëvlen ana e Kryetarit.

Art. 13. Sinodhi ka dhe një Sekretar të përgjithëshëm i cili proponohet prej Sinodhit dhe emrohet me dekret të Kryepeshkopit. Cilsi e Sekretarit të përgjithëshëm caktohen në Rregulloren e Administrimit të përgjithëshëm.

### KAPTINA E III

## Peshkopatat

Art. 14. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ndahet në katër Peshkopata:

a) Peshkopata e Korçës, Përmetit, Voskopojës, Leskovikut dhe Kolonjës.

b) Peshkopata e Durësit, Tiranës, Shkodrës, Kavajës, Elbasanit, Shpatit, Gorës, Mokrës, Pogradecit dhe Dibrës.

c) Peshkopata e Beratit, Vlorës, Myzeqesë dhe Kaninës.

ç) Peshkopata e Gjinokastrës, Delvinës, Drëpullit, Pogonit dhe Himarës, me kufit që ka pasë gjer më sot gjith-sc-cila prej këtyre.

Kufitë e Peshkopatave munt të ndryshohen

me propozimin e Sinodhit, me pëlqimin e Qeverrisë dhe me dekret Mbretnuer.

Qendra e Kishës Autoqefale caktohet me dekret mbretnor. Gjer sa të dalë dekreti relativ Kryesia e Kishës qëndron në Korçë.

Peshkopë pa Dhiqezë nuk munt të jenë ma tepër se dy.

Art. 15. Kryepishkopi zgjidhet prej Sinodhit për gjithë jetën e tij. Në rast që Kryepishkopi i zgjedhar prej Sinodhit nuk pëlqehet prej Mbretit, Sinodhi detyrohet të zgjedhi një tjetër të cilin i a paraqit Mbretit për pëlqim dhe dekretim. Të gjithë këto veprime për zgjedhje, propozim dhe refuzim mbahen sekrete.

Gjithë në këtë mënyrë zgjidhen dhe Peshkopët e tjerë.

### Cilësit e Peshkopëve

Art. 16. Kryepishkopi, Peshkopët, Zavendësit e tyre lokalë, Ikonomi i Math Mitrofor, Sekretar i Përgjithshëm i Sinodhit, si edhe ndihmësit e Zavendësit Klerikë të Kryepishkopit dhe të Peshkopëve, duhet të jenë prej gjaku, gjuhe Shqiptarë si edhe të kenë nënshtrësinë

Shqiptare.

Art. 17. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorzohen, përveç cilësive t'Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanunet e Kishës, si edhe të kenë mbaruar një fakultet Theologjie.

Në rast nevojë, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, munt të dorëzohet Peshkop edhe ay që ka diplomë fakulteti drejtësie, filologjie, ose të një Seminari Orthodoxks në gradë Liccu.

Art. 18. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e tjerë më parë se të fillojnë në detyrën e tyre detyrohen të bëjnë betimet e shënuara më poshtë, një përpara Mbretit, një përpara Sinodhit të Shenjtë.

Betimi përpara Mbretit asht:

Betohem dhe premtoj mbi nderin tim (si Kryepeshkop ose Peshkop) përpara Perëndisë se do të jem kurdoherë besnik i Mbretit të Shqiptarvet, i Atdheut dhe i Statutit të Mbretërisë. Detyrohem të ve në be në këtë mënyrë dhe gjithë Klerikët që do të dorzohen prej meje.

Betimi përpara Sinodhit asht:

Betohem mbi ndërgjegjen time (Kryepeshkopale ose Peshkopale) përpara Perëndisë se do të ruaj besnikërinë kundrejtë dogmave, kanuneve dhe rregullave Kishëtare që përmbajnë bashkimin dogmatik fetar dhe solidaritetin me Patriarhitë dhe Kishat Orthodhokse Autoqefale të botës.

### Transferime

Art. 19. Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dhioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut.

Art. 20 Peshkopët munt të transferohen me vendimin e Sinodhit dhe pas pëlqimit e dekretimit Mbretëror.

### Pushime

Art. 21 Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëve dhe i Ikonomit të math Mitrofor babet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinare dhe për arsye ekstraordinare.

a) Për faje të rënda dogmatike e kanonike gjykohen prej një këshille dymbëdhjet vetash, përveç Kryetarit, të përbërë prej gjithë anëtarëve të Sinodhit të Shenjtë, përveç të akuzuarit, prej

Peshkopëve Titullarë dhe prej graduatësh Klerikë gjer më numurin e sipër-caktuar gjashtë prej të cilëve i zgjeth i akuzuari. Vendimi jepet me tri të katërtat e votave e me vota të fshhta, pasi të digjohet ma parë apologjia e të akuzuarit.

b) Për faje ordinare Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi Math Mitrofor pushohen në rast dënimi kundër lirisë personale në një ndëshkim ma tepër se një vit dhe si kur këtij ndëshkimi të mos i jetë shtuar ndalimi nga ofiqet publike; dhe kur dënohen me burgim të rëndë, ose me dënime të fajeve relative për fallsifikim, vjedhje, mashtrim, keq-përdorim besimi dhe atentate kundër zakoneve të mira.

Në këto raste dhe Sinodhi detyrisht vëndos pushimin e tyre.

c) Për arsye ekstra ordinare, të shpjeguara drejt për drejt e me dekret mbretnor Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Math Mitrofor, për veç rasteve të përmendura në paragrafin e sipërm, largohen me një herë nga detyra me dekret Mbretëror.

Në rast dekretimi largimi prej detyre të Kryepeshkopit, ky zëvëndë-sohet me një herë prej

peshkopit më të vjetër në dorzim; në rast dekretim largimi të një Peshkopi, Kryepeshkopi emëron me një herë zëvendësin e përgjithshëm.

Në rast pushimi të tillë brënda dyzet ditëve ipso fakto, mblidhet Sinodhi i cili bashkë me pushimin e të larguarit, vëndos zgjedhjen e Peshkopit për përmbushjen e Dhiocëzës vakante.

Në rast pushimi të Kryepeshkopit, për çfarë do arsye, ky ka të drejtë të marrë një rrogë të përmuajshme prej pes-qind frangash ari.

Gjith ashtu në rast pushimi për çfarë do arsye të Peshkopëvet dhe të Ikonomit të Math Mitrofor këta marrin nga një rrogë të përmuajshme prej 300 fr. ari.

Art. 22. Kryepeshkopi, Peshkopët, dhe Ikonomi i Math Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojn të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikrisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos. Po Sinodhi mundet edhe motu proprio të çfaqë mejetimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodhit vetë dy prej të sëmurit, dhe një prej Drejtorisë

së P. të Shëndetsisë.

Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk apin dorheqjen brënda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodhi me një herë emëron një ndihmës Peshkop i cili merr për sipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët të deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonit e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin as një pjesë aktive n'administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërin e tyre, ata japin dorëheqjen tue marrë nga arka e përgjithëshme e Kishës një shpërbllim të përmuajshëm për Kryepeshkopin Gjashtë qind franga ari, dhe për Peshkopët katër qind fr. ar.

## Detyrat e Peshkopëve

Art. 23 Kryepeshkopi dhe Peshkopët në Dhiocëzat e tyre janë autoriteti Kishëtar dhe ushtrojnë të gjitha detyrat që janë caktue në kanunet e Shenjta, në rregulloret Kishëtare dhe në këtë Statut. Ata janë nën juridiksionin e Sinodhit dhe eksku-

tojnë vendimet dhe urdhërat e tija, si pas dispozitave të këtij Statuti.

Për çdo kundërvajtje ose pa kujdesi në detyrat e tyre Kishëtare janë përgjegjës përpara Sinodhit. Në Gusht të çdo viti janë të detyruar të paraqesin një raport të veprimeve të tyre dhe të gjendjes së Peshkopatës. Ky raport këndohet përpara Sinodhit dhe mos-paraqitja e tijë konsiderohet si një shkelje detyre.

Art. 24 Kryepeshkopi dhe Peshkopët, në Dhioqezat e tyre, si në Qendër ashtu dhe në rrethet e sajta, ushtrojnë të gjitha detyrat të imponuara prej Kanuneve Kishtare; Celebrojnë Mysteret e Shenjta; Predikojnë fjalën e Shënjte; konsakrojnë Kishët e Shenjta; përkujdesen që të përmbushin të gjitha shërbësat fetare, si pas dispozitave tipike relative: përkujdesen për zbulimin e hiëshëm të Kishave si edhe të Ikonave të Shënjta vendosja e të cilave kërkon autorizimin e tyre të më parëshëm; përkujdesen për enët e pekat e Shenjta dhe për çdo gjë tjetër që përdoret në Kishë.

Art. 25. Kryepeshkopi dhe Peshkopët detyrohen të shëtisin njëherë në vit në për Dhioqezat e tyre për përmbushjen e detyrave Peshkopale.

Kryepeshkopi për Dhioqezën e tij munt t'ja ngarkojë këtë detyrë ndihmësive Peshkopë ose, në mungesë Zëvendësit të tij.

Art. 26. As një Peshkop nuk munt të largohet prej Dhioqezës së vet pa marrë lejen nga Kryetari i Sinodhit dhe gjithashtu nuk munt të qëndrojë në Peshkopatën e një peshkopi tjetër pa autorizimin e këtij.

Art. 27. Kryepeshkopi dhe Peshkopët emrojnë Zëvendësit e Tyre në konformitet me Artikullin gjashtëmbëdhjet (16) të këtij Statuti.

Art. 28. Ikonom i Math Mitrofor asht i detyruar të kryej çdo mision që i ngarkohet prej Sinodhit dhe merr pjesë në të me të gjitha të drejtat e çdo antari.

Në rast që mbetet vakant vëndi i Ikonomit të Math Mitrofor, nuk zëvendësohet me tjetër person dhe ky ofiq suprimohet.

#### KAPTINA E IV.

### Masa disiplinore.

Art. 29. Kryepeshkopi dhe Peshkopët, për gabime të lehta Kishtare të Klerikëve dhe të Murgëve që ndodhen në jurisdiksionin e tyre, pa



si të dëgjohej ma parë i akuzuari, kanë të drejtë të ndëshkojnë në mënyrë të preme dhe pa tjetër formalitet procedure:

a) me qërtim;

b) me pezullim (Argji) nga çdo shërbim fetar gjer më pesmbëdhjet dit.

Për këto ndëshkime Peshkopi mban një proces-verbal, i cili ruhet në arqivat e Peshkopatës.

Art. 30. Në qëndrën e çdo Peshkopate ekziston një Këshillë Kishtare disiplinore e cila gjykon fillimisht për faje fetare klerikët dhe Murgët që ndodhen nënë jurisdiksionit e sajë ose qëndrojnë në atë Peshkopatë. Kjo Këshillë Kishtare përbahet prej Peshkopit vetë si kryetar dhe prej katër Priftërinjve si antarë. Këta emërohen dhe pushohen prej Peshkopit dhe emrimi ose pushimi i tyre i njohet Sinodhit.

Kryepeshkopi dhe Peshkopët mund të formojnë në Këshillën Kishtare disiplinore edhe jashtë Qendrës. Vëndimet merren me shumicë votash. Kur Kryepeshkopi dhe Peshkopët ndodhen të penguar vëndin e tyre e zënë zëvëndësit klerikë. Kjo Këshillë përbahet kurdo herë prej pesë anëtarësh dhe plotësohet në mungesë me ndonji prej tyre.

51171899

Art. 31). Këshilla kishëtar ka të drejtë të japë këto ndëshkime:

a) Qërtim

b) Pezullim (argji) nga çdo shërbesë fetare jo më tepër se një vit;

c) Prerje rroge të shoqëruar me ose pa pezullim gjer në një vit.

Ndëshkimet me qërtim dhe me pezullim (argji) gjer më 40 ditë janë të preme; të tjerat janë të apeluarshme nga ana e t'akuzuarit për para Këshillës disiplinore të përherëshme në qëndrën e Kishës.

Në qoftë se një klerik akuzohet për një faj të rëndë që provokon skandull, Kryepeshkopi ose Peshkopi munt t'a ndalojë këtë me një herë nga shërbesa fetare po jo ma tepër se dy muaj.

#### KAPTINA e V

### Këshilla disiplinore e përherëshme

Art. 32). Në qëndrën e Kishës krijohet një Këshillë Disiplinore e përherëshme që përbahet prej Kryepeshkopit si Kryetar dhe prej katër antarëve, Peshkopë ose Klerikë graduatë, të zgjedhur prej Sinodhit. Ky zgjedhë katër anëtarë

suplementarë për të zëvendësuar anëtarët në rast mungese.

Kur Sinodhi ndodhet i hapur, detyrën e kësaj Këshille e përmbush ai-vetë.

Të gjitha vendimet e keshillës Disiplinore të përherëshme merren me shumicë votash.

Art. 33) Këshilla disiplinore e përherëshme gjykon:

a) Apelisht dhe definitivisht vendimet e apeluarshme të keshillave disiplinore të Peshkopatave;

b) Fillimisht fajet e rënda të cilat, pas vendimit të keshillës Disiplinore Peshkopale sjellin dënime më të mëdha se ato të shënuara në artikullin 30, si dhe fillimisht çgradimin definitiv (katheresis).

Vendimet të dhëna fillimisht prej keshillës disiplinore të përherëshme apelohehen përpara Sinodhit.

Art. 34—Apeli i vendimeve të dhëna prej keshillës disiplinore të peshkopatave dhe të keshillës disiplinore të përherëshme bahet mbrenda 30 ditëve prej datës në të cilën i komunikohet të dënuarit vendimi. Ky komunikim do t'i bëhet të interesuarit mbrenda 15 ditëve prej datës së vendimit.

Kërkesa e apelit i dorzohet Kryetarit të keshi-

llës që dha vendimin, i cili mbrënda 15 ditëve, e dërgon në keshillën disiplinore të përherëshme.

Art. 35. Sinodhi gjykon a) Apelisht dhe definitivisht të gjithë vendimet të dhëna Keshillës disiplinore të përherëshme; b) Peshkopët dhe Ikonomin e Math Mitrofor për fajet të lehta.

Vendimet e dhëna prej Keshillave disiplinore me pezullim sbatohen me një herë.

Art. 36. Kryepeshkopi për fajet të lehta dhe të rënda Kishtare dhe Peshkopët dhe Ikonomi i Math Mitrofor për fajet të rënda Kishtare gjykohehen përpara keshillës së formuar si pas artikullit 21 §a.

Art. 37. Të gjitha vendimet që sjellin pushimin e Kryepeshkopit, të Peshkopëve dhe të Ikonomit Math Mitrofor i paraqiten Mbretit për dekretin.

Art. 38. Ekzekutimi i dënimit për çgradim (katheresis) i klerikëve bëhet sipas kanunevet Kishtare dhe i dënuari me çgradim detyrohet të nxjerr petkat fetare dhe shenjat e tjera të ofiqit për ndryshe dënohet në bazë të artikullit 214 të Kodit Penal.

KAPTINË E VI

## Organizimi i administrimit të pasunisë

Art. 39 Kishat, Manastiret dhe pasunitë e tyre të tundëshme dhe të patundëshme si dhe ato të komunitetit Orthodhoks janë të siguruara në konformitet me ligjet e Shtetit.

Art. 40 Bu ime Financiare të Kishës janë:

- a) Të ardhurat e kishëve dhe të Manastireve si dhe të pasurive të komunitetit Orthodhoks;
- b) Subvansioni i dhanë prej shtetit për ndihmën e kishës;
- c) Pagesa fakultative si dhe çdo far dhurate ose ndihme e dhënë prej Shqiptarve.

Art. 41. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e çdo Dhioqeze kanë të drejtë të mbledhin ndihmat fakultative të zakonëshme për dobin e Kishës ose personale të tyre nga çdo familje Orthodhokse, siç do të caktohet në rregullore.

Art. 42. As një pasuri e pa tundëshme kishtare ose Manastiriale si edhe e komunitetit Orthodhoks nuk munt të jetërsohet pa vendimin e këshillës Mikst, për ndryshe jetërsimi asht i pa-

vlefshëm.

Mënyra e administrimit dhe e çfrytimit të pasurive të tundëshme dhe të patundëshme si edhe mënyra e shitjes së pasurive të tundëshme të kishave, Manastireve dhe komuniteteve Orthodhokse caktohet në Regulloren e përgjithëshme të administrimit.

Art. 43. Autoritetet e kishës Autoqefale detyrohen t'i paraqesin kur të kërkohen, inspektorit të Ministris së Drejtësisë të gjitha llogaritë e t'ardhurave e të prishunave. Në rast që konstatohet se është bërë abuzim, kundër-vepronjësit dërgohen në gjyq prej Ministris së Drejtësis dhe dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

KAPTINA E VII

## Këshilla mikst

Art. 44. Për administrimin dhe kontrollimin e pasurive të kishave, të Manastireve të komuniteteve Orthodhoksë të çdo lloji dhurate dhe ndihme si dhe të subvencionit të shtetit krihet në Qendrën e Kishës një këshillë me emnin "Këshilla Mikst" e përbërë prej të gjithë anëtarvet të Sinodhit dhe prej katër Llaikësh, një për

çdo Dhioqez, nën kryesinë e Kryepeshkopit.

Të zgjedhurit e Laikëve në fjalë dhe kompetenca si dhe të drejtat e tyre do të caktohen në Regulloren e administrimit të kishës Orthodhokse Autoqefale.

Për këtë herë katër anëtarët laik zgjidhen prej kongresit.

Regullorja e administrimit të përgjithshëm do të elaborohet prej Këshillës Mikst të cilës do t'i shtohen edhe katër anëtarë laik një prej çdo Dhioqeze të zgjedhura po prej këti kongresi. Në Regulloren do të caktohen rrogat dhe shpërblimet e Kryepeshkopit, Peshkopëve dhe Ikonimit të Math Mitrofor si dhe të nëpunsëve të tjerë klerikë dhe laikë; do të formulohet mënyra e zgjedhjeve të Pleqsive Kishëtare (Dhimogjerondive) dhe të kujdestarëve të kishave e të Monastireve.

Kjo Regullore do të elaborohet prej Këshillës Mikst, të formuar si ma sipër, mbrënda gjashtë muajve pas datës së dekretimit të këtij Statuti.

Art. 45. Këshilla Mikst harton për çdo vit buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës. një kopje e të cilit i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë, për veprimet e parapame në dispozitat e Re-

gullores së përgjithshme t'administrimit.

Art. 46. Pasurit e tundëshme dhe të patundëshme që u janë lanë komuniteteve Orthodhoksë. Kishëve ose Manastireve me një qëllim mirëbërës të caktuar, udohën nën —kontrollimin e Kishës e cila përkujdeset për të kryemit e qëllimit dhe për ekzekutimin e dëshirës së dhuronjësit.

Art. 47. Pran Krye—kishës krijohet Arka e përgjithëshme në të cilën hyjnë të gjitha të ardhurat, e Kishës si pas artikullit 40 dhe prej kësaj bahen pagesat si pas Regullores së administrimit.

Art. 48. Çdo zëvendës-lokal bashkë me Pleqsinë Kishëtare harton Buxhetin preventiv të përvitshëm për të gjitha të ardhurat dhe të prishurat të juridikeies së tijë për pasurit e komuniteteve Orthodhokse dhe për pasurit dhe të ardhurat e Kishave. Ky buxhet i dërgohet Peshkopatës kompetente gjer më një Gusht. Peshkopata, pasi të mbledhi buxhetet e të gjithë Dhioqezës së sajë, me verejtjet e duhura, ja dërgon Qendrës mbrenda 30 ditëve.

Art. 49. Për çdo Manastir hartohet një buxhet i veçantë i cili më një Gusht i paraqitet Peshkopatës dhe kjo ja dërgon Qendrës me verejtjet

e dhura dhe bashkë me buxhetet e tjera për aprovim.

Art. 50. Viti financiar i Kishës fillon më një Janar dhe buxheti preventiv i dërgohet çdo Peshkopate përpar kësaj date.

Buxheti konsumptiv hartohet brënda muait Mars për të ardhurat dhe të prishurat e vitit të shkuar. Ky buxhet, bashkë me tepricën e t'ardhurave, i dërgohet çdo Peshkopate brënda muait Mars.

Teprica e t'ardhurave të Manastireve i dërgohet Qendrës në çdo 6 muaj.

Art. 51. Në qendrën e Kishës ndodhet një Këshillë ekonomike e përhershme që përbëhet prej Kryepeshkopit dhe katër laikëve. Këto të fuadit zgjidhen prej Këshillës Mikst dhe detyrat e tyre caktohen në Rregullore.

Art. 52. Në Arkën e Përgjithëshme të Kishës Autoqefale të Shqipërisë nuk munt të mbahen ma tepër se katër mijë fr. ari, teprica depozitohet në një nga Bankat Shqiptare n'emrin e sajë dhe tërhiqet si pas dispozitave të Regullores s'administrimit.

Ar. 53. Regullorja e Administrimit të përgjithshëm

për të hyr në fuqi, duhet të aprovohet nga Ministria e Drejtësis.

#### KAPTINA E VIII

54 Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë detyrohet në çdo mesh të baj lutje për Mbretin, për gjith Kombin Shqiptar dhe për ushtërin.

Art. 55 Kisha Autoqefale e Shqipërisë n'asnjë mënyrë nuk munt të pranojë, në çdo emër qoftë, dhurata nga një fuqi e huaj dhe veprimi i kundërt shkaktton zbatimin e dispozitave të ligjës mbi fajet politike.

Art. 56 Sinodhi do të veprojë për përmirsimin që kërkojnë konditat shoqërore të sotme mbi sa u përket zakoneve fetare.

Art. 57 As një klerik nuk munt të funksionojë fen orthodhokse në Shqipëri pa qënë i emruar dhe i lidhur me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Art. 58 Të gjithë ata Klerikë për të cilët flet artikulli 16 dhe që ndodhen në shërbim të Kishës Autoqefale të Shqipërisë të cilët nuk kanë konditat e lypuna prej atij artikulli, që ditën e aprovimit të këtij Statuti janë të pushuar nga funk-

sioni Fetar klerikal.

Art. 59 As një llaik ose Murg nuk mund të dorzohet Prift ose Dhiak pa patur pëlqimin e Sinodhit dhe pa patur diplomën e Seminarit Orthodhoks.

Art. 60 Të gjitha maredhانيت që do të ketë Kisha Autoqefale e Shqipërisë me Qeverinë Mbretnore do të bahen me anën e Ministris së Drejtësis.

Art. 61 Çdo Peshkopatë ka vulën e sajë në të cilën do të jet shkruar: Peshkopata e (Emni i Dhiqezës).

### Dispozitat e fundit

Art. 62 Në rast heresie të një pjese ose të gjithë popullsis Orthodhokse të një krahine kishat Manastiret dhe pasurit e tyre i mbeten kishës Autoqefale të Shqipëris.

Art. 63 Në as një mënyrë nuk mund të ndryshohen, të modifikohen ose të abrogohen artikuit 1, 2 e 3.

Art. 64 Mund të ndryshohen me vendim të këshillës mikst bashk me këshillën e përhershme artikuit: 10; 14 §a, b; 25; 40; 48; 49; 52 e 60.

Dispozitat e tjera të këtij statuti munt të ndryshohen me vendim të një kongresi tjetër.

Ky statut i paraqitet Qeverrisë për të marrë formën ligjore.

Korçë, 29 Qershor, 1929

Delegat i Tiranës *Kryepeshkop Vissarion d.v.*  
» » *Dr Athanas Shundi d.v.*  
» » *Dr Zoi Xoxa d.v.*  
Delegat i Shpatit *Taq Buda d.v.*  
Delegat i Shkodrës *At Velisha Popoviq*  
» » *Naum Plevneshi d.v.*  
» » *Mitro Llazareviq d. v.*  
Delegat i Korçës *Ik. i M. Mitrofor At Vasil Marko d.v.*  
» » *Stavraq Ballauri d.v.*  
» » *Thoma Turtulli d.v.*  
» » *Vasil Avrami d.v.*  
» » *Sotir Kotta d.v.*  
Delegat i Përmetit *Dhimitri Kacimbra d.v.*  
Delegat i Gjinokas rës *Thoma Papapano d.v.*  
» » *Konstandin Lito d.v.*  
» » *Episkop Ambrozi d.v.*  
» » *Ikonom Papavlashi*  
Delegat i Libohovës *Dhimosthen Haxhoglu d.v.*  
Delegat i Leskovikut *Andon Kito d.v.*  
Delegat i Lushnjës *Llazar Bozo d.v.*

Delegat i Vlorës *Kristaq Ikonomi d.v.*  
» » *At Isaia d.v.*  
» » *Kristo Karbunara d.v.*  
Delegat i Delvinës *Mihal Maksakuli d.v.*  
Delegat i Sarandës *Apostol Papa Dhima d.v.*  
Delegat i Konispolit *Loli Qesko d.v.*  
Delegat i Durrësit *Kristaq Zaguridhi d.v.*  
» » *Vasil Bakalli d.v.*  
» » *Moisi Popa d.v.*  
De'egat i Kavajës *Kleanth Mineu d.v.*  
De'egat i Himarës *Dr Mihal Cane*  
Delegati i Beratit *Episkop Imzot Agathangel d.v.*  
» » *Dr Nikolla Haxhistasa d.v.*  
» » *Ikon. At Theodor Brisku d.v.*  
Delegat i Fierit *Jovan Xoxa d.v.*  
Delegat i Mallakastrës *Ikonom At Polizoi d.v.*  
Delegat i Kolonjës (Ersekë) *Petro Prodani d.v.*  
Delegat i Bilishtit *Petro Ilija d.v.*  
Delegat i Tepelenës *Dhimitër Mole d.v.*  
Delegat i Elbasanit *Kostaq Cipo d.v.*  
» » *Kor Deliana d.v.*  
» » *Dhimitër Papajani d.v.*  
Delegat i Poradecit *Spiro Naço d.v.*  
Delegat i Dibrës *Stavrofor Ik. Josifi d.v.*  
» » *Dr. Filip Papajani d.v.*  
» » *Garril Lasku d.v.*  
Komisari i Qeveris pranë Kongresit Panorthodhoks  
Shqiptar në Korçë: *Vasil Bidoshi d.v.*